REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT

DREJTORIJA E INSPEKTORATIT

Datë :	**03.11.2020**
Referencë	**11-344/10**
Për :	**Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës**
Kopje:	**Fauz Xhemajli-Nënkryetar i Komunës**
Kopje:	**Lulëzim Qerimi-Nënkryetar i Komunës**
Nga:	**Imer Rrustemi- Drejtori i Inspektoratit**
Lënda :	**Raporti i muajit-tetor**

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë muajit kemi vazhduar duke punuar me dy ndërrime të punës nga ora 08-16 dhe 16-24, ku kemi inspektuar subjektet afariste rreth respektimit të masave anti- Covid. Në bazë të vendimeve të Qeverisë së Kosovës për masat anti-Covid si dhe së fundmi Ligji për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19, ne vazhdimisht kemi inspektuar në teren së bashku edhe me Policinë e Kosovës se a po respektohen këto masa që rrjedhin në bazë të Ligjit dhe vendimeve, subjektet afariste vazhdimisht janë njoftuar dhe urdhëruar që ti respektojnë këto masa. Përveç subjekteve afariste kemi inspektuar edhe personat fizik në respektimin e këtyre masave.
Vazhdimisht jemi në koordinim me Drejtorin e QKMF-së si dhe Policin e Kosovës duke i monitoruar rastet me Covid-19, ku në bazë të listave që vijnë nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Republikës së Kosovës, ne përgatisim vendimet për izolim të personave pozitiv si dhe shfuqizimin e këtyre vendimeve pasi këta persona të dalin në listë si të shëruar.
Në këtë muaj është inspektuar kryesisht në lidhje me firmat e auto-taksive, në lidhje me disa të cilët nuk i kishin të vendosur shiritin në automjet ku janë urdhëruar që të bëhet vendosja e tyre në qytet si dhe në Aeroportin Ndërkombëtar Adem Jashari në Vrellë për disa auto-taksi. Po ashtu kemi inspektuar firmat e autobusëve ne disa relacion si Lipjan –Magure dhe Dobraj e Madhe në lidhje me rende të udhëtimit. Janë inspektuar edhe trotuare në disa rrugë të qytetit se mos po hasim ndonjë të parkuara në trotuar apo me pjesë të gjelbëruara, si dhe bizneset se mos po hasim ndonjë biznes që nuk po i respekton masat mbrojtëse.
Janë inspektuar objekte ndërtimore në terren dhe është identifikuar një objekt shtëpi-banimi jashtë zonës ndërtimore, pa leje ndërtimi, ndaj të cilit janë ndërmarr masat ligjore, ndërsa inspektimet tjera rezultojnë me Leje ndërtimi. Janë inspektuar edhe objekte të tjera në bazë të kërkesës së Investitorëve.
Duke përfshirë edhe aktivitetet tjera emergjente të Pandemisë. Inspektorati ka bashkëpunuar ngushtë me Policin dhe Drejtorit tjera.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë muajit u jemi përgjigjur kërkesave dhe ankesave të palëve, si dhe kemi bërë përgatitjen e lëndëve të cilat i kanë ndaluar policia personat fizik për mos respektimin e masave anti- Covid dhe ne këto lëndë i kemi dorëzuar si fletëparaqitje në Gjykatën Themelore në Prishtinë-dega në Lipjan.
Me kërkesën e një kompanie është bërë exs-humimi i mbetjeve mortore të një personi të kombësisë serbe, mbetjet mortore janë larguar nga varrezat e qytetit të Lipjanit për në varrezat Bubanjë në Nish të Serbisë. Ky exs-humim është bërë me pëlqimin e familjareve dhe kërkesën e tyre pa ndonjë presion tjetër.

STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspektime	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje për Covit-19	Inspektime për pirjen e duhanit	Kallëzim penal	Pëlqime sanitare	Vërejtje, njoftime	Mbyllje e përkohshme e lokaleve	Të hyra nga pranimet teknike	Vendime për vetë izolim dhe vendime për shfuqizim të vetë izolimit	Punë me palë, ankesa , kërkesa	Lendet e pranuara	Lende te pezulluara, ekzekutuara gjygjesore	Gioba mandatore	Ins. Te biznesve për vendosjen e flamujve afër artikujve	Inspektim te tokave, farëra, plehra dhe ins.i pylltarisë	Ins. I biznesve se sa i respektojnë vendimet e Qeverisë për parandalimin e virusit Covid-19	Ins. I kafshëve në thertore	Menaxhim I tregjeve	Aktvendime, ndalesa, urdhëresa, vendime	Inspektim me polici	Inspektim I biznesve pa regjistrim pa pranim teknik	Persona të vdekur nga covid-19	Exs humim
Biznesi	738	32	8	129								41			1			323		8		186	10		
Ambienti																									
Sanitarët	898	12		137			1				65	6						630				42		4	1
Bujqësia	315	17		265				6				20										7			
Ndërtimi	139	12		118				8													1				
Trafiku	116	18		2				38				16	8							4	2	28			
Gjithsej	2206	91	8	651	/	/	1	52	/	/	65	83	8	/	1	/	/	953	/	12	3	263	10	4	1

DISKUTIMET PUBLIKE

Nuk kemi mbajt diskutime publike për shkak pandemisë Covid-19.

TAKIME TË TJERA

I kemi mbajt veç e veç në biznesin e tyre gjatë inspektimit.

SFIDAT

Sfidë e inspektoratit mbetet se si ta parandalojmë pandeminë me theks të veçantë të ju përmbahemi rekomandimeve të IKSHPK-së si dhe vendimit të Qeverisë konkretisht M.SH.

REKOMANDIMET

Rekomandimet e inspektoratit te bizneset janë në përputhshmëri me rekomandimet e IKSHPK-së si dhe MSH.